



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. _____, datë _____

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR MIRATIMIN
E MARRËVESHJES KUADËR, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE *EAGLE
HILLS REAL ESTATE DEVELOPMENT, ALBANIAN SEAPORTS
DEVELOPMENT COMPANY, SH.A., DHE NSHMI DEVELOPMENT
L.L.C, PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT STRATEGJIK
“MARINA & JAHTET E DURRËSIT”*”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, 83, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për miratimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe *Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company, sh.a., dhe Nshmi Development L.L.C*”, për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, për shqyrtim e miratim, me procedurë të përsheptuar, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2022

PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES KUADËR, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE *EAGLE*
HILLS REAL ESTATE DEVELOPMENT, ALBANIAN SEAPORTS
DEVELOPMENT COMPANY, SH.A. DHE *NSHMI DEVELOPMENT*
L.L.C, NË LIDHJE ME PROJEKTIN E INVESTIMIT STRATEGJIK
“MARINA & JAHTET E DURRËSIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimi i marrëveshjes

Miratimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe *Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company, sh.a.* dhe *Nshmi Development L.L.C*, për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, si dhe të shtojcave të kësaj marrëveshjeje kuadër, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Regjimi i posaçëm në zbatim të marrëveshjes

1. Shoqëria e përbashkët për realizimin e projektit “Marina & Jahtet e Durrësit” përjashtohet nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja dhe kontributin e strehimit social, sipas legjislacionit në fuqi për sistemin e taksave vendore dhe legjislacionit në fuqi për strehimin social. Vlera e detyrimit të përjashtuar është pjesë e kontributit të shtetit shqiptar në investim, sipas marrëveshjes së përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji.

2. Dhënia e lejeve, licencave dhe akteve të tjera administrative të nevojshme për realizimin e projektit të investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, bëhet sipas legjislacionit në fuqi, por, në çdo rast, brenda një afati prej jo më shumë se 150 ditësh.
3. Pronat e paluajtshme shtetërore, të transferuara në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit” (*Durrës Yachts & Marina*), me vendim të Këshillit të Ministrave i kalojnë në pronësi shoqërisë “*Albanian Seaports Development Company*”, sh.a.

Neni 3

Miratimi i statutit të shoqërisë së përbashkët

Kushtet thelbësore që duhet të përmbajë statuti i shoqërisë së përbashkët janë sipas shtojcës 8, që i bashkëlidhet ligjit.

Neni 4

Miratimi i marrëveshjeve

1. *Albanian Seaports Development Company*, sh.a., lidh marrëveshjen e zhvillimit dhe kontratën për transferimin e titullit të pronësisë, sipas tekstit të dokumenteve, bashkëlidhur këtij ligji.
2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lidh marrëveshjen “Për Marinën e Durrësit”, sipas tekstit të dokumentit, bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 5

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e aktit nënligjor sipas pikës 3, të nenit 2, të këtij ligji.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA